VENDIM
Nr. 514, datë 18.9.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO-ROMANOS–KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT DHE CAKTIMIN E BASHKISË DURRËS SI NJËSI ZBATUESE

(ndryshuar me VKM-në nr. 512, datë 27.7.2022; nr. 506, datë 30.8.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 1 990 639 140.6 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e dyzet pikë gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos–Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit.

2. Bashkisë Durrës, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 398 127 828 (treqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos–Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, në formën e transfertës së pakushtëzuar. Efekti financiar të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

2/1. Bashkisë Durrës, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, i transferohet fondi në masën 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë pa TVSH, për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos – Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, në formën e transfertës së pakushtëzuar, dhe të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

2/2 Bashkisë Durrës, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi, në masën 892 511 312.6 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos–Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023 dhe i transferohet Bashkisë Durrës, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese për financimin e zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos–Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama